ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Një ankesë kundër: **Komisioni Qendror i Zgjedhjeve**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **320-22-10406-2-2-1**

Sa i përket tenderit për: **Ritender - Sigurimi fizik i objekteve të KQZ-së**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

SKYFTERAT-LIVE SH.P.K
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rr.Rexhep Bislimi 1
(Adresa)

Prizren
(Vendi)

70000
(Kodi postar)

048 100 800
(Numri Telefonit)

N/A
(Numri i Faks-it)

Njazi Syla
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

skyfterat-live@hotmail.com
(Adresa elektronike)

04.01.2023
(Data e parashtrimit të ankesës)

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

_____

(Emri i avokatit)

_____

(Adresa e plotë)

_____ _____

(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

_____

(Adresa elektronike)

_____ _____

(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës" apo "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit", afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

- **Njoftimi për kontratë, 27.09.2022**
- **Hapja e ofertave, 18.10.2022**
- **Njoftimi mbi vendimin e AK, 02.12.2022**
- **Njoftimi mbi vendimin e AK (Rivlerësim), 12.12.2022**

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po					**Jo**	**X**	

Jo, nuk kemi marrë pjesë në procesin e hapjes së tenderëve, ofertat janë hapur në mënyrë elektronike. Raporti i hapjes së ofertave është ngarkuar në platformën e E-Prokurimit me datë 18.10.2022 në ora 14:09.

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit? A keni bërë ndonjë reagim me shkrim dhe/ose kërkuar sqarime shtesë nga AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj, si dhe a u është përgjigjur me shkrim AK në lidhje me këtë? Nëse po, ofroni shkurtimisht detaje mbi këtë fakt:

Po	**X**				**Jo**		

Po jemi eleminuar nga ana e Autoritetit Kontraktues. Me datën 12.12.2022 pasi që është ngarkuar Njoftimi mbi vendimin e AK (Rivlerësim), kemi pasur rezultatin si ofertues i eleminuar.

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

- **Neni 7 (LPP)-Barazia në Trajtim/Jo-Diskriminimi**
- **Neni 59 (LPP)-Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve**
- **Neni 65 (LPP)-Pranueshmëria e Kandidatëve ose Tenderuesve**

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë e rrejshme ose mashtruese.*

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Në lidhje me aktivitetin e prokurimit "**RITENDER–Sigurimi fizik i objekteve të KQZ-së**" të inicuar nga AK: Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me nr.prokurimi "320-22-10406-2-2-1" japim pretendimet tona ankimore si më poshtë:

Autoriteti Kontraktues me rastin e vlerësimit dhe krahasimit të ofertave nuk na ka trajtuar në mënyrë të barabartë dhe përkundrazi ka vepruar në mënyrë diskriminuese plotësisht në kundërshtim me dispozitën e Nenit7 të Ligjit për Prokurimin Publik.

Dispozita ligjore e lartëcekur paragrafi 1 thotë:
Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.

Poashtu dispozita tjetër paragrafi 2 thotë:
Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirët e një ose më shumë operatorëve ekonomik.

Me datën18.10.2022 është bërë hapja e tenderit në fjalë ku edhe është bërë publikimi i Procesverbalit të hapjes së ofertave në platformën e E-prokurimit.

Pas shkarkimit të procesverbalit kemi gjithsejt vetëm dy (2) oferta të dorëzuara për aktivitetin e prokurimit në fjalë.

Me datën 02.12.2022 kemi kërkuar qasje në dokumentet e aktivitetit të prokurimit përmes formës elektronike, dhe pas insistimit që dokumentet e OE të rekomanduar për kontratë t'i pranojmë në formën elektronike përmes e-mail AK na ka dërguar dokumentet me datën 05.12.2022.

Më pastaj kemi dorëzuar kërkesë për rishqyrtim me datën 07.12.2022 ku me datën 08.12.2022 ju si AK e keni aprovuar pjesërisht ankesën tone duke e kthyer lëndën në Rivlerësim.

Me datën 12.12.2022 keni publikuar sërish njoftimin mbi vendimin e AK (Rivlerësim), ku përsëri është shpallur fituesi i njejtë.

Me datën12.12.2022 kemi kërkuar sërish për të dytën herë qasje në dokumentet e OE të rekomanduar për kontratë dhe të njejtat dokumente të kërkuara i kemi pranuar me datën 13.12.2022.Gjatë analizimit të dokumenteve të pranuara nga AK përmes qasjes që e kemi pasur, kemi vërejtur se dëshmitë e pranueshmërisë të dorëzuar nga OE i rekomanduar për kontratë kishte dorëzuar Vërtetimin e lëshuar nga Administrata Tatimore e Kosovës(ATK) tregon se ka borxhe mirëpo është në marrëveshje për shlyerjen e borxheve.

Vërtetimi i lëshuar me nr.serik 1000987019 me datë 06.12.2022 ka validitet vetëm 90 ditë ashtu siç shënohet edhe në vërtetim.

Me datën 13.12.2022 kemi kërkuar sërish nga Autoriteti Kontraktues të na dërgon kopjen e marrëveshjes së lidhur ndërmjet operatorit ekonomik dhe ATK-së, të njejtit nga kthejn email ku tregojnë se nuk e posedojnë marrëveshjen e operatorit ekonomik me ATK për shlyerjene borxheve. Ne nëpërmjet këtij dokumenti dëshironim të vërtetonim se marrëveshja e lidhur a është para publikimit të njoftimit të kontratës apo pas njoftimit mbi vendimin e AK-së, pasi që tek platorma elektronike (E-Prokurimi) KRPP-ja ka lëshuar një interpretim ligjor në lidhje me rastin në fjalë kur OE-të janë në marrëveshje me ATK për shlyerjen e borxheve.

"...Nisur nga fakti se shumë OE kanë marrëveshje për shlyerje të borxheve me ATK-në,KRPP sqaron se edhe në këtë rastmarrëveshjet për shlyerje të borxheve duhet të jetë para datës së publikimit të njoftimit të kontratës".

<u>Provë:</u> Interpretimi ligjor i KRPP-së me nr.6 e datës 22.11.2022.

Paragrafi 4.8 i nenit 65 të LPP përcakton: 4.8 "aktualisht është me vonesë në pagimin e çfarëdo kontributeve për sigurim social apo tatim në Kosovë ose në vendin e themelimit të operatorit ekonomik, përveç ku një borxh i tillë është vërtetuar të jetë jo i rëndësishëm në Kosovë". Në kuptim të paragrafit 4.8 të nenit 65 të LPP-së, termi "aktualisht" nënkupton çdo herë që kërkohet në Dosjen e Tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë dëshmi për të vërtetuar se OE nuk është në vonesë në

pagimin e çfarëdo kontributeve për sigurim social apo tatim në Kosovë, OE duhet të sjellë dëshminë për të vërtetuar se një gjendje e tillë nuk ekziston.

Kur OE rekomandohet për dhënie të kontratës, para publikimit të Njoftimit mbi vendimin e AK-së, nga i njëjti kërkohet dëshmia "Vërtetimi nga ATK" dhe për të qenë "**i pranueshëm**" OE sipas nenit 65të LPP-së, duhet të vërtetojë se nuk është në vonesën në pagimin e tatimeve ndaj ATK-së.

Qëllimi i këtij neni është që OE duhet të jetë gjithmonë "**i pranueshëm**", pra OE nuk duhet të ketë obligimetë pashlyera.

Andaj Autoriteti Kontraktues "**Komisioni Qendror i Zgjedhjeve**" gjatë vlerësimit, krahasimit dhe ekzaminimit të ofertave për aktivitetin e prokurimit në fjalë nuk ka vepruar konform **Nenit 59.4 të LPP-së** (kërkesave në dosjen e tenderit).

Provë: Vërtetimi i ATK-së i dorëzuar nga kompania e rekomanduar.

Dispozita ligjore e Nenit 59.4 të LPP-së thotë:
Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tenderusi të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit...

Mbështetur në të gjitha këto argument dhe dispozita ligjore, kërkojmë nga Paneli Shqyrtues që të merret ky vendim:

Të aprovohet si e bazuar ankesa, dhe të kthehet lënda në Rivlerësim, që gjatë rivlerësimit komisioni të ketë në konsideratë Nenin 59.4 të LPP-së duke eleminuar OE të rekomanduar për kontratë si të papërgjegjshëm dhe të papranueshëm dhe duke na shpallur neve si fitues i kësaj kontrate si i vetmi operator i përgjegjshëm, bazuar në kërkesat e vendosura në Njoftimin për kontratë dhe Dosjen e tenderit.

Mbesim me shpresë se do ta keni në konsideratë këtë ankesë, bazuar në provat dhe argumentet si dhe interpretimet ligjore të KRPP-së.

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës:

Si palë me interes, na shkaktohen dëme në të mira materiale, si mos dhënia e mundësisë në ofrimin e shërbimeve në KQZ, shpenzimet e krijuara për punimin e Ankesave pranë zyreve ligjore.

9. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- *një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- *një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".*
- *një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- *një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, dhe*
- *të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*